VENDIM
Nr. 240, datë 23.12.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO) DHE ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E NEMO-s DHE OPERATORËVE TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË NË TREGUN E BASHKUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 57, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, VKM-së nr. 322, datë 15.5.2019, "Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut", Direktivën nr. 2016/1148, "Mbi sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike" (NIS), e njohur ndryshe dhe si Direktiva mbi "*Cybersecurity*" nenit 19, pika 1, germa f dhe nenit 26, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga Drejtoritë Teknike me nr. 119/3 prot., datë 18.12.2019, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO-s dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar

konstatoi se:

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, gjatë takimit të Grupit të Energjisë, të zhvilluar në Bosnjë, në datë 23.10.2019, ka propozuar që në Rregulloren e licencimit, për disa ndryshime në të cilën ka filluar procedurën ERE, të parashikohen edhe kriteret e funksionimit të Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), siç është rekomanduar nga Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB), në mbledhjen e datës 24.4.2019.
- Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) ka mbështetur masat rregullatore për implementimit e kushteve të Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë nga palët kontraktore të Komunitetit të Energjisë.
- Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve (*Capacity Allocation and Congestion Management*) (CACM) përcakton qartë se për të bërë të mundur funksionimin e bashkimit të tregjeve, të ditës në avancë të sektorit të energjisë elektrike, në vendet anëtare të Sekretariatit dhe Bashkimit Evropian, duhet të përcaktohen përgjegjësitë e operatorëve të sistemit të transmisionit (OST) dhe operatorëve të tregut të ditës në avancë (NEMO).
- Në mënyrë që operatorët e tregut të ditës në avancë të jenë të integruar institucionalisht në procesin e bashkimit të tregjeve, Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve përcakton një kornizë për përcaktimin e Operatorëve të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
- Roli i NEMO-s është funksionimi i tregjeve të ditës në avancë dhe/ose *intraday* nën regjimin e bashkimit të tregjeve, siç përcaktohet në Rregulloren për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve. Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve gjithashtu siguron kritere të hollësishme sipas të cilave Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike (*Nominated Energy Market Operator*) (NEMO) do të përcaktohet dhe funksionojë.
- ENC ka propozuar që ERE të marrë masa për të hartuar/integruar në aktet rregullatore, objekt miratimi e shqyrtimi nga ERE, edhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së Operatorit të Tregut.

- Në vlerësim të sugjerimeve të Sekretariatit në lidhje me parashikimin e kritereve të Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), u hartua drafti i cili reflekton propozimet e sekretariatit, si dhe të Bordit të Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB).

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO), rolet dhe përgjegjësitë e NEMO-s dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti